



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 584/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimiq dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Gani Kocit, paraqitur kundër komisionarëve të disa qendrave të votimit, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet si e palejuar ankesa e Gani Kocit.

A R S Y E T I M

Më datën 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Gani Koci kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e PDK-ës i cili thekson se “komisionarët në Qendrat e Votimit 2103b-Likoc, 2110b-Vojnik, 2113b- Leqinë, 2114b-Runik, 2121b- Abri e Poshtme , 2122b- Makermal, 2106b-Kline e Eperme, 2102b- Qubrel, 2132b- Baks, 2123b-Izbic, 2109b- Krasaliq, dhe qendra të tjera, kanë manipuluar votat të cilat i përkasin atij, duke i vendosur për kandidatë të tjere. Sipas parashtruesit të ankesës të gjithë formularët përfundimtar janë plotësuar në bazë të një liste të imponuar nga persona të caktuar. Në të gjitha këto qendra ka pasur edhe shkelje të tjera të tjera siç janë: votimi i shumëfishtë i grupeve të caktuara për kandidatë të caktuar. Gjithashtu sipas parashtruesit të ankesës në bisedat që ka pasur me komisionarët dhe vëzhguesit, del se mbi ta është bërë presion për të heshtur dhe për të vepruar sipas diktatit të caktuar zyrtar”. Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë materiale që do të shërbente si dëshmi për rastin në fjale.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 4 paragrafi 2 parasheh:

PZAP-i mund ti hidh poshtë (si të palejuara, të parregullta parregullta apo të pasafatshme) ankesat të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, poashtu PZAP-refuzon ankesat të cilat janë të pabazuar, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e Panelit të Zgjeruar të datës 16.12.2010, Anr. 490/2010. Pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 584/2010 më datën 16.12.2010

Kryesuesi i Panelit

Ferit Osmani

